



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 54-të, të mbajtur më 02.11.2021, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Kërkesa e regjistruar sipas numrit 12-929/1 të 26.02.2021. Refuzohet.

KSHPK përcaktoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-929/1 të datës 26.02.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Më 25 mars 2021, një kërkesë u dërgua nga një parashtrues i njohur dhe është formuar lënda me numër 12-929/1 të 26.02.2021.

Kallëzimi i dorëzuar në fakt është kundërshtim ndaj një urdhri përmbarrimor të datës 08.02.2021, në të cilin parashtruesi thekson se ekziston një lidhje kriminale ndërmjet përmbarruesve nga ----- dhe ----- me Kryetarin e Gjykatës Themelore ne -- ----- dhe se Kryetari i kishte rrezikuar jetën duke i kërkuar para për dëmshpërblim. Më pas ai tregon se si provë ka vërtetim për dokumentet e sekuestruara në vitin 1999 për pensionin e invaliditetit të 20 personave. Më tej thuhet se parashtruesi nuk ka para për shpenzimet e shërbimeve publike, ilaçe dhe dru, nuk ka të ardhura, se llogaria e tij bankare është e bllokuar që në vitin 1999 dhe se kryetari i gjykatës ka dhënë qëllimisht gjykime joreale ndaj tij. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se ai ka dorëzuar kundërshtim në Gjykatën Themelore ----- për urdhëratë e zbatimit brenda tri ditëve, por thekson disa përmbarruesve, avokatë, gjyqtarë, policë dhe kryetar komunash që e mbajtën peng për 30 vjet. Në shtojcë të denoncimit, ndër të tjera është dorëzuar edhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore ----- i datës 22.02.2021, me të cilin kundërshtimi i parashtruesit të këtij denoncimi kundër urdhrit të përmbarrimit, prej datës 08.02.2021 refuzohet si i paafatshëm për faktin se debitori e ka pranuar urdhrin përmbarrues në fjalë me datën 09.02.2021, ndërsa kundërshtimi është dorëzuar më 17.02.2021, pra pas skadimit të afatit ligjor prej 3 ditësh.

Pas shqyrtimit të pohimeve në lëndë, KSHPK - ja konstaton se denoncimi nuk përmban pohime apo paligjshmëri konkrete që tregojnë për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar nga personat zyrtarë, gjegjësisht në të njëjtën shpreh pakënaqësi nga vendimi i gjykatës pas kundërshtimit kundër urdhrit përbarimor në bazë të borxheve të parashtruesit, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:  
Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH  
Miratoi: K.N, anëtar i KSHPK - së

**KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
KRYETAR  
Biljana Ivanovska**

